



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 237, Datë 22.09.2022

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 10 MW, ME VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE NR. 3038, FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE
DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU I FIERIT**

Në mbështetje të neneve 16, nenit 37, pika 2, gërma “a”, dhe nenit 38, pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1539/4 prot., datë 19.09.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku i Fierit”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 202, datë 10.08.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 MW, për një afat 25-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure në datat 12.08.2022 dhe 13.08.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.08.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1387/1 prot., datë 18.08.2022, ERE iu drejtua shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për ta njoftuar mbi fillimin e procedurës, nisur me vendimin e bordit nr. 202/2022 dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387/3 prot., datë 25.08.2022. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezultoi se mbetej ende informacion/dokumentacion pa plotësuar, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1387/5 prot., datë 12.09.2022 për plotësimin e tij. Në vijim shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387/6 prot., datë 13.09.2022.
- ERE me shkresën nr. 1387/2 prot., iu drejtua dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), duke i kërkuar informacion mbi nënshkrimin e kontratës përkatëse me shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., sikurse përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 417, datë 15.06.2022 “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku i Fierit, nga shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k.” dhe sqarim në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta, të parashikuar në këtë VKM.
- MIE ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387/4 prot., datë 31.08.2022, ku është shprehur se në zbatim të VKM-së nr. 417, datë 15.06.2022, ka nënshkruar kontratën përkatëse me shoqërinë “EZ-E ENERGY” sh.p.k. si dhe ka specifikuar se referuar pikës 1 gërma iii) të VKM-së nr. 417/2022, krijimi i shoqërisë për qëllime të veçanta është një e drejtë dhe jo detyrim i shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.
- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga Studimi i Fizibilitetit për ndërtimin e impiantit fotovoltaike 10 MW rezulton se jetëgjatësia e burimit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 MW, për një afat 25-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI